



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



LICENCË PËR FURNIZIM ME SHUMICË (TREGTIM) TË ENERGISË ELEKTRIKE

DHËNË :

“GEN-I TIRANA” SH.P.K. DEGA NË KOSOVË

Numri i Regjistrimit: ZRRE/Li_34/12

Prishtinë, 14.12.2016



PËRMBAJTJA


KREU I : TERMAT E LICENCËS	3
KREU II: KUSHTET E LICENCËS	4
Neni 1: Përkufizimet	4
Neni 2: Ndalimi i Subvencioneve dhe Ndër-subvencioneve.....	5
Neni 3: Pajtueshmëria me Kodin e Rrjetit, Kodin e Shpërndarjes, Kodet e Matjes dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji	5
Neni 4: Rregullat e Tregut.....	5
Neni 5: Shëndeti dhe Siguria.....	5
Neni 6: Puna.....	6
Neni 7: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit.....	6
Neni 8: Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së.....	6
Neni 9: Vazhdimi,Modifikimi, Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës	7
Neni 10: Taksat	7
Neni 11: Masat Administrative dhe Gjobat	7
Neni 12: Zgjidhja e Kontesteve	8



KREU I TERMAT E LICENCËS

1. **Zyra e Rregullatorit për Energji (tani e tutje "ZRRE")**, në pajtim me autoritetin e dhënë me Nenin 28 paragrafin 2, nënparagrafin 2.11 dhe Nenin 34 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084), Nenin 18 paragrafin 2 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081), Nenin 32 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085), dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë i lëshon **"GEN-I TIRANA" SH.P.K. me adresë: Rr.Gustav Mayer 16, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës (tani e tutje "i Licencuari") Licencën për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike.**
2. Territori që mbulohet nga kjo Licencë është i tërë territori i Republikës së Kosovës.
3. Licenca lëshohet për shitblerjen e energjisë elektrike me kapacitet total **deri 400 MW.**
4. I Licencuari mund të:
 - 4.1. blejë kapacitete dhe energji elektrike nga prodhuesit me çmime të parregulluara;
 - 4.2. blejë dhe shes kapacitete dhe energji elektrike nga furnizuesit tjerë me çmime të parregulluara;
 - 4.4. shes kapacitetet dhe energjinë elektrike furnizuesve tjerë me çmim të pa-rregulluar; dhe
 - 4.5. transitojë, importojë dhe eksportojë kapacitete dhe energji elektrike.
5. Licenca vlen nga data **29 dhjetor 2016** dhe do të vazhdoj të jetë e vlefshme deri **28 dhjetor 2021**, me mundësi vazhdimi në përputhje me Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

E Vulosur me vulën e rëndomtë të Zyrës së Rregullatorit për Energji më: _____

Nënshkruar nga Ushtruesi i Detyrës i Kryesuesit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, z. **Krenar Bujupi** (në emër të Bordit të ZRRE-së): 

Nënshkruar me datë: 14.12.16





KREU II KUSHTET E LICENCËS

Neni 1 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë licencë do të kenë kuptim si në vijim:

"Anëtar" - marrëdhënia e drejtpërdrejt ose indirekte me të Licencuarin, çdo ndërmarrje Aksionare apo Vartës i të Licencuarit, apo ndonjë vartës të një ndërmarrje Aksionare të të Licencuarit, e themeluar sipas legjislacionit në fuqi.

"Eksportimi i energjisë elektrike" - transmetimi i energjisë elektrike nga Kosova në një vend tjetër, në kuptimin se në të njëjtën kohë energjia elektrike do të pranohet nga ai vend.

"Importimi i energjisë elektrike" - pranimi i energjisë elektrike në Kosovë nga një shtet tjetër me kuptimin se në të njëjtën kohë energjia elektrike do të pranohet.

"Vit financiar" - periudha prej 1 Janar deri me 31 Dhjetor të të njëjtit vit kalendarik.

"Shoqëri Aksionare" - çdo ndërmarrje e definuar si e tillë sipas legjislacionit në fuqi.

"Legjislacion" - Ligjin për Energjinë (Ligji Nr. 03/L - 184), Ligji për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L - 185), Ligjin për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 03/L - 201), dhe çdo legjislacion tjetër primar ose dytësor që rregullon sektorin e energjisë.

"Rregulla të Tregut" - rregulla të miratuara nga ZRRE që përcaktojnë funksionimin e tregut të energjisë elektrike dhe raportet në mes të Operatorit të Tregut dhe pjesëmarrësve në treg, si dhe bashkëveprimet midis këtyre palëve dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit

"Kode" - rregullat teknike të nxjerra nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sipas Ligjit për Energjinë Elektrike dhe të aprovuara nga ZRRE-ja, në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

"Marrëveshje për Blerje të Energjisë" – marrëveshja për blerjen e energjisë elektrike me prodhuesin e energjisë në pajtim në Nenin 18 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

"Vartës" - çdo ndërmarrje në pronësi apo e kontrolluar nga një ndërmarrje tjetër, e që definohet sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë.

"Transit" - transportimi i energjisë elektrike përmes Sistemit të Transmisionit të Kosovës, me ç'rast as prodhimi dhe as pranimi korrespondues i energjisë elektrike nuk realizohet në Kosovë;



2. Termet tjera të përdorura në këtë licencë do të kenë të njëjtin kuptim si termet e përdorura në Legjislacionin në fuqi.

Neni 2

Ndalimi i Subvencioneve dhe Ndër-subvencioneve

I Licencuari do të parandalojë apo evitojë që aktiviteti për furnizim me shumicë, import dhe eksport të energjisë elektrike të jap apo të marrë ndonjë subvencion apo ndër-subvencion (direkt apo të tërthortë) prej ndonjë aktiviteti tjetër të Licencuarit dhe/ose ndonjë Vartësi (ortaku) apo anëtar, dhe/ose ndonjë person tjetër.

Neni 3

Pajtueshmëria me Kodin e Rrjetit, Kodin e Shpërndarjes, Kodet e Matjes dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji

1. I Licencuari do të veprojë në përputhje me dispozitat e Kodit të Shpërndarjes, Kodit të Rrjetit Elektrik, Kodet e Matjes dhe Rregullës mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.
2. Licencuari mund të kërkojë derogim (shtyrje) në zbatimin e atyre dispozitave që nuk është e mundur të zbatohen sipas paragrafit 1 të këtij Neni. ZRRE-ja pas shqyrtimit të kërkesës nga i Licencuari mund të lejojë apo refuzojë derogimin (shtyrjen) e afatit të zbatimit.

Neni 4

Rregullat e Tregut

1. I Licencuari do të veprojë në përputhje me Rregullat e Tregut në fuqi.
2. I Licencuari mund të kërkojë derogim (shtyrje) në zbatimin e disa dispozitave të Rregullave të Tregut. ZRRE-ja pas shqyrtimit të kërkesës nga i Licencuari mund të lejojë apo refuzojë derogimin (shtyrjen) e afatit të zbatimit.

Neni 5

Shëndeti dhe Siguria

I Licencuari do të ndërmerr të gjithë veprimet e nevojshme për të mbrojtur personat nga lëndimet që mund tu shkaktohen atyre nga ana e të Licencuarit gjatë kryerjes së aktivitetit të furnizimit me shumicë, import dhe eksportit të energjisë elektrike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.



Neni 6 Puna

I Licencuari lidhur me marrëdhënien në punë dhe sigurinë në punë do të veprojë në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

Neni 7 Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit

1. I Licencuari do të njoftojë ZRRE-në për ndonjë ndryshim që pritet në kontroll së paku gjashtëdhjetë (60) ditë paraprakisht. Ndryshimi në kontroll nuk do të jetë efektiv deri sa ZRRE-ja nuk e aprovon.
2. I Licencuari do të njoftojë ZRRE-në për ndonjë ndryshim të Strukturës Organizative të të Licencuarit. Njoftimi i tillë do t'i bëhet ZRRE-së jo më vonë se tre (3) ditë nga data e çdo ndryshimi të tillë.

Neni 8 Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së

1. I Licencuari do t'i dorëzojë ZRRE-së informacione dhe raporte në lidhje me kontratat e energjisë me ndërmarrjet tjera të licencuara nga ZRRE, në mënyrën dhe në afatet që ZRRE-ja do t'i kërkojë.
2. Nëse i Licencuari, në pajtim me Rregullën për Informatat Konfidenciale kërkon që ndonjë informatë të konsiderohet si konfidenciale, ai ka për obligim që të shënjojë informatën e tillë si konfidenciale dhe të arsyetojë kërkesën e tij te ZRRE-ja. ZRRE do të shqyrtojë kërkesën e tillë në pajtim me Rregullën për Informatat Konfidenciale.
3. Zyra e Rregullatorit për Energji ka të drejtë të kërkojë nga i licencuari çdo informatë konfidenciale, të nevojshme për përmbushjen e funksioneve dhe detyrave të saj, në pajtim me Nenin 12 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
4. I Licencuari do të emërojë një person përmes të cilit do të ketë lidhje komunikimi me Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Operatorin e Tregut. Adresa, numri i telefonit, faksit apo adresa elektronike e personit të tillë do t'i dërgohet Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Operatorit të Tregut.
5. I licencuari do t'i dërgojë ZRRE-së detajet mbi çdo ndryshim të informatave të dërguara me aplikacionin për këtë licencë.



Në këtë Nen:

"Informacioni" - materiali në çdo formë dhe pa asnjë kufizim do të përfshijë çdo kontratë, libër, dokument, regjistër, kontabilitet, llogaritje (statusore ose tjetër), vlerësim, kthim ose raport të çdo përshkrimi dhe çdo shpjegim (gojor ose me shkrim) në lidhje me këto informacione që mund të jenë kërkuar nga ZRRE-ja.

Neni 9

Vazhdimi, Modifikimi, Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës

1. ZRRE-ja mund të vazhdojë, modifikojë, pezullojë, dhe ndërpresë këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
2. ZRRE-ja mund të transferojë këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, por duke siguruar që obligimet e licencës mund të kryhen nga i Licencuari tjetër dhe nëse konsumatorët nuk do të dëmtohen për shkak të një transferimi të tillë.

Neni 10

Taksat

I Licencuari do t'i paguajë ZRRE-së çdo taksë fillestare dhe vjetore të caktuar sipas Rregullës për Taksat, të nxjerrë nga ZRRE-ja.

Neni 11

Masat Administrative dhe Gjobat

1. Në rast shkeljeje të dispozitave të legjislacionit në fuqi, përfshirë Rregullat e nxjerra nga ZRRE, apo Nenet dhe kushtet e kësaj Licence, apo udhëzimet e dhëna të Licencuarit nga ana e ZRRE-së, ZRRE-ja ka kompetenca t'i vendos të licencuarit masa administrative dhe gjoba, në përputhje me Nenin 52 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.
2. Masat administrative dhe gjobat mund t'i vendosen ndërmarrjes si subjekt juridik si dhe personave përgjegjës të ndërmarrjes.
3. Shuma e gjobës do të vlerësohet në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.



Neni 12 **Zgjidhja e Kontesteve**

1. Çdo kontest që paraqitet apo është i lidhur me aktivitetet e licencuara do të zgjidhet sipas Rregullës për Zgjedhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë të, nxjerrë nga ZRRE-ja.
2. Vendimet e ZRRE-së lidhur me vazhdimin, modifikimin, pezullimin, ndërprerjen dhe transferin e licencës, si dhe vendimet lidhur me gjobat si rezultat i shkeljeve të kushteve të licencës apo shkeljes së ligjeve në fuqi, mund të kontestohen nga i Licencuari në Gjykatën kompetente sipas ligjeve në fuqi.